

KLSH merr pjesë në takimin vjetor të Grupit të Punës së EUROSAT-t për Auditimin e Bashkive (WGMA)

Në datat 02-05 tetor 2024, u zhvillua në Tbilisi Gjeorgji takimi vjetor i Grupit të Punës së EUROSAT-t për Auditimin e Bashkive. Takimi ishte i organizuar në zhvillimin e një seminari me temë “Projektet infrastrukturore në qeverisjen vendore” dhe më pas në zhvillimin e takimit të përvitshëm të Grupit të Punës për Auditimin e Bashkive.

Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga vendet e Bashkimit Evropian si dhe nga vendet e rajonit. KLSH u përfaqësua nga z. Bledar Doracaj dhe znj. Ermira Hoxha.

Takimi u hap me fjalët përshëndetëse të Drejtuesve të SAI-t të Letonisë, në cilësinë e Drejtuesit të Grupit të Punës dhe të SAI-t të Gjeorgjisë, në cilësinë e vendit mikpritës të aktivitetit. Në fjalën e tyre u theksua se si WGMA ka ardhur duke u konsoliduar nga viti në vit, duke u kthyer nga një Taskforcë në një Grup Pune, si dhe se sa të rëndësishme janë këto takime për secilin SAI pjesëmarrës, për të përfituar nga eksperiencat e njëri-tjetrit dhe për të shpalosur ide të reja për të ardhmen.

Gjatë zhvillimit të seminarit u paraqitën prezantime nga drejtues të bashkive të Gjeorgjisë, të cilët ndanë me të pranishmit eksperiencën dhe përfitimet që kanë patur si rezultat i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga audituesit e SAI-t.

Gjithashtu, u prezantuan eksperiencat e disa SAI-ve në auditimin e projekteve infrastrukturore si dhe bashkëpunimet me institucionet e vetëqeverisjes vendore.

Në ditën e dytë u diskutua lidhur me aktivitetet dhe angazhimet që do të kryhen në vijim nga anëtarët e grupit të punës për përmbushje të objektivave strategjike, kontributin e SAI-ve për WGMA Newsletter, projekti për plotësimin e bazës së të dhënave lidhur me auditimet e zhvilluara, planifikimi për të përgatitur një material mbi auditimet e zhvilluara nga SAI-t në fushën “Auditime në sistemin parashkollor dhe atë të edukimit të përgjithshëm”.

